

AKT- THEMELIMI

I SHOQËRISË TREGËTARE ME PËRGJËGJËSI TË

KUFIZUAR

“HOTEL IMPERIAL” SH.P.K

Ortak:

Shoqëria “**BIGALB GROUP**” shpk. Person Juridik shqiptar, regjistruar pranë Regjistrisë Tregtare në QKB, pajisur me Nipt L11521002M, me seli në Tiranë, Vaqarr, Fshati Gropaj, Godina Tirana Cash & Carry, kati 2, me Person të Besuar Znj. Valmira Dedgjoni , atësia Lik, e dtl. 05.12.1975, e lindur në Kamëz dhe banuese në Tiranë, me adresë “A.Vokshi”, Nd.104; H.2, Njësia Administrative Nr.9; Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi (ID Card) Nr. Pers H56205074V lëshuar më datë 23.08.2021.

Në bazë të legjislacionit shqipëtar ka vendosur me vullnet të lirë dhe të plotë, themelimin e shoqërisë tregtare private, me përgjegjësi të kufizuar, të emërtuar “**HOTEL IMPERIAL**” Sh.p.k e cila do të rregullohet në mbështetje të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”; ligji Nr.9723 date 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar , si dhe të legjislacionit shqiptar në fuqi dhe normave që vijnë:

Neni 1

Të themelojë një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar të quajtur “HOTEL IMPERIAL” Sh.p.k. “HOTEL IMPERIAL” Sh.p.k. është një subjekt juridik Shqiptar, të cilit i lind e drejta të ushtrijë aktivitetin që nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB). Shoqëria “HOTEL IMPERIAL” Sh.p.k zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin Shqiptar dhe me aktet e themelimit të tij.

Neni 2

Shoqëria do të jetë e formës së shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar dhe përballon humbjet sipas ligjit.

Neni 3

Objekti i aktivitetit ekonomik të shoqërisë do të jetë:

- Hotel,
- Strukturë akomoduese;
- Strehim i përkohshëm;
- Rezervime akomodimi (Të përkohshëm);



- Rezervime hoteli
- Shërbime për sigurimin e ushqimeve dhe pijeve.

Neni 4

Shoqëria “HOTEL IMPERIAL” Sh.p.k ka selinë e saj në adresën: Vlorë, Vlorë, VLORË, Rruga "Murat Tërbaçi" Zona Kadastrale nr.8602, pasurie nr.36/49+1-N14, 36/49+1- N13,36/49+2-N16/1,36/49+1- N17, Vlorë.

Neni 5

Kapitali themeltar i Shoqërisë “HOTEL IMPERIAL” Sh.p.k do të jetë **1.000.000 (një milionë)** lekë dhe është i përbërë nga shuma në të holla, derdhur nga ortaku i vetëm.

Neni 6

Pala kontraktuese ka rënë dakord të përcaktoj kuotën e pjesëmarrjes si më poshtë:

Emri	Kuota	Përqindja	Kontributi në lekë
BIGALB GROUP	1	100%	1.000.000

Neni 7

Kohëzgjatja e shoqërisë “HOTEL IMPERIAL” Sh.p.k do të jetë me afat të pacaktuar. Ajo mund të shpërbëhet në cdo kohë me vendim të ortakut të vetëm.

Neni 8

I gjithë kapitali i vënë nga ortaku themelues është tërësisht dhe plotësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm nga ana e tij.

Neni 9

Në librin e llogarisë që do të krijohet në Shoqërinë Tregtare do të shënohet dhe kapitali i derdhur nga ortaku i vetëm. Rritja e kapitalit themelor të shoqërisë nuk është e kufizuar.

Neni 10

Në kohën e prishjes së shoqërisë ose të përfundimit të afatit, kur nuk ka zgjatje afati, kapitali i shoqërisë pasi të hiqen debitë e saj, do të ngelet tërësisht tek ortaku i vetëm.

Neni 11

Fitimi i realizuar nga veprimtaria ekonomike e shoqërisë, pas shlyerjes së detyrimeve ligjore dhe ato që kanë lindur me të tretët, është plotësisht i transferueshëm dhe për tu depozituar në një nga Bankat Shqiptare, ose për tu përdorur sipas nevojave të ortakut të shoqërisë.

Neni 12

Ortakut ka këto të drejta dhe detyra themelore:

- të derdh kuotën e kapitalit bazë sikundër është përcaktuar në nenin 6,
- të marr pjesë në drejtimin e shoqërisë,
- të tërheq fitimin e realizuar,
- të tërheq aktivin resultant nga bilanci i likuidimit në rast të pushimit të aktivitetit të shoqërisë,
- të ruaj sekretin e aktivitetit të shoqërisë,
- të impenjohet për arritjen e objektivave të shoqërisë.

Neni 13

Organet e shoqërisë “HOTEL IMPERIAL” Sh.p.k janë:

- Ortaku i vetëm i shoqërisë
- Administratori i shoqërisë.

Modalitetet e formimit dhe funksionimit të tyre do të përcaktohen në statutin e shoqërisë
Administrator i shoqërisë do të jetë Znj. Joana Ferzaj për një afat 5 vjeçar.

Neni 14

Shoqëria është person juridik shqipëtar dhe do të ushtrojë veprimtarinë e saj ekonomike private në bazë të legjislacionit shqipëtar në fuqi dhe veçanërisht ligji 9901 date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” si dhe ligji Nr.9723 date 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, të K. Civil si dhe të akteve ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të tyre.

Neni 15

Marrëdhëniet e punësimit në shoqëri do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punësimit, që lidhet midis palëve në mbështetje të ligjit Nr.7961, date 12.07.1995 (KODIT TË PUNËS), si dhe akteve të tjera në zbatim të tij.

Neni 16

Mosmarrëveshjet e mundshme që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë private të shoqërisë midis punonjësve brenda saj, si dhe me të tretët, kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, çështja mbetet në kompetencë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë.



Neni 17

Për sa nuk përshkruhet në këtë kontratë themelimi do të aplikohen nenet e statutit të shoqërisë dhe dispozitat e legjislacionit shqipëtar.

Neni 18

Ky Akt-themelimi është përpiluar dhe firmosur në tre kopje me vlerë të njëjtë me origjinalin.

Datë 21 / 01 / 2025

ORTAKËT THEMELUES

**Shoqëria "BIGALB GROUP" Sh.p.k.
Z. Vullnet Sinaj**

**Person i Besuar
Znj. Valmira Dedgjoni**

Valmira Dedgjoni
